



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: 6.7.2023

Nr: 25

Ora: 17:00

VENDIM
PËR

**MIRATIMIN E DISA AFATEVE PROCEDURIALE QË LIDHEN ME PËRSËRITJEN E ZGJEDHJEVE PËR
KRYETARIN E BASHKISË RROGOZHINË, QË DO TË ZHVILLOHEN MË DATË 23 KORRIK 2023**

Në mbështetje të nenit 6, nenit 20, pika 1, shkronja "a", nenit 36, nenit 92 dhe nenit 161 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

1. Fushata zgjedhore për zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë, fillon më datë 10 Korrik 2023.
2. Bashkia Rrogozhinë dhe institucionet e saj të varësisë janë të detyruara të raportojnë në KQZ, të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën 10 Korrik 2023 deri ditën e zgjedhjeve.
Të njëjtin detyrim kanë edhe institucionet publike qendrore, organet e tyre të varësisë dhe degët e tyre vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, për veprimtari me karakter publik, që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën 10 Korrik 2023 deri ditën e zgjedhjeve, në territorin e Bashkisë Rrogozhinë ose për të.
Raportimi duhet të kryhet jo më vonë se tre ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë.
3. Autoriteti i Mediave Audiovizive monitoron OSHMA-të për veprimtaritë me karakter publik të institucioneve publike të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, nga data 10 Korrik 2023, nga ora 08:00-00:00 ose sipas rastit deri në përfundimin e programit.
4. Partitë politike të cilat kanë të drejtë të paraqesin anëtarë në KQV, duhet t'i depozitojnë kandidaturat në KZAZ-në përkatëse, jo më vonë së data 13 Korrik 2023. KZAZ-ja merr vendim për emërimin e anëtarëve të KQV-ve brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga data e dorëzimit të propozimeve.
5. Partitë politike të cilat kanë të drejtë të paraqesin anëtarë në GNV duhet t'i depozitojnë kandidaturat në KZAZ, jo më vonë së data 17 Korrik 2023. KZAZ-ja merr vendim për emërimin e anëtarëve të GNV-ve, brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga data e dorëzimit të propozimeve.

Data: 6.7.2023 Nr: 25
Ora: 17:00



"Për miratimin e disa afateve proceduriale që lidhen me përsëritjen e zgjedhjeve për kryetar në Bashkinë Rrogozhinë, që do të zhvillohen më datë 23 Korrik 2023"

6. Paraqitja e kërkesës për akreditimin e vëzhguesve shqiptarë bëhet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve jo më vonë se data 17 Korrik 2023 dhe për vëzhguesit e huaj bëhet jo më vonë se data 17 Korrik 2023. Akreditimi i vëzhguesve bëhet nga KQZ-ja jo më vonë se data 21 Korrik 2023.
7. Paraqitja e kërkesave për akreditim nga ana e subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhje bëhet në KZAZ jo më vonë se data 18 Korrik 2023. Akreditimi i vëzhguesve bëhet jo më vonë se data 20 Korrik 2023.
8. Rezultatet e sondazheve zgjedhore nuk mund të publikohen gjatë 3 (tre) ditëve të fundit para datës së zgjedhjeve, përfshirë edhe datën e zgjedhjeve deri në orën e mbylljes së votimit.
9. Monitoruesit e fushatës zgjedhore të angazhohen nga data 10 Korrik deri më datë 23 Korrik 2023, me përfundimin e procesit të votimit.
10. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
11. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
12. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO	Kryetar
Arens ÇELA	Anëtar
Dritan ÇAKA	Anëtar
Helga VUKAJ	Anëtar
Muharrem ÇAKAJ	Anëtar